



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:116923

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05739844

**K.DH.SH.II.nr.811/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Danki DOO me seli ne Preshevë rr 15 Nëntori nr. 17253, te cilin e përfaqëson Dorentina Rexhaj, avokate në Prishtinë, ndaj debitorit Pika Group SHPK me NUI 810113259 me seli Suhareke fshati Mushtisht , me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës Dhomat e Shkalles se pare- Departamenti për çështje Ekonomike Përgjithshëm, KPPP.nr.193/23 i dt.18,09.2024, me datën 24.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e kreditorit Danki DOO me seli ne Preshevë rr 15 Nëntori nr. 17253, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës Dhomat e Shkalles se pare- Departamenti për çështje Ekonomike Përgjithshëm, KPPP.nr.193/23 i dt.18.09.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykatës Komerciale e Kosovës Dhomat e Shkalles se pare- Departamenti për Çështje Ekonomike Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.193/23 i dt.18.09.2024,, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit, ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor Pnr.nr.11/23 të datës 13.01.2023 i lëshuar nga Përmbartuesi seli ne Prishtinë, ndërsa përfundohet procedura përmbartimore ne këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së dispozitave të procedurës përmbartimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles së Dytë, të nxjerr aktvendim me të cilin aprovohet në tërësi ankesa e ushtruar nga kreditori, si e bazuar, te refuzohet ne tersi prapësim i debitorit dhe të vërtetohet përmbartimi sipas urdhrin përmbartimor ose lenden ta kthej ne rivendosje.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të

Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

**-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës nr. 1/2019 dt.13.01.2019 te përshkruara ne propozimin e urdhrin përmbartimor. Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr. nr.11/23 të datës 13.01.2023, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit qe rrjedh nga faturat t'i paguaj shumën prej 2,218 euro, me kamatë prej 8% si dhe shpenzimet tjera te procedurës.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me pretendimin se te ndërprite procedura dhe lënda te dërgohet ne gjykate te rregull.

Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkalles se pare, Departamenti për çështje Ekonomike, me aktvendimine ankimuar, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se ne shkresat e lendes nuk ka dëshmi se faturat mbi bazën e se cilave është lejuar përmbartimi janë pranuar nga debitori, te njëjtat fatura nuk janë nënshkruar nga personi-subjekti ne emër dhe mbiemër dhe si te tilla nuk përbejnë bazë për përmbartim, ndërsa kreditori nuk ka mundur ti argumentoj pretendimet e tij me asnjë provë te cilat do te ndikonin ne një vendosje ndryshe nga ka vendosur ne dispozitiv te aktvendimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila fature nuk kanë qenë e nënshkruar nga pranuesi i faturës, e që në këtë rast nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm. Neni 29 par.1 nënpar.1.1 përcakton se: “ 1. *Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1 kambialet dhe çequet me potest dhe faturë kthyese, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës*”. Në këtë rast e rëndësishme është që të vërtetohet se a është pranuar fatura nga ana e debitorit, pra e njëjta a është nënshkruar sepse kjo nënkupton se debitori i ka pranuar detyrimet e tij që i ka ndaj kreditorit.

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i

bazuar. Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkalles se Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshatshme për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar*”.

Gjykata e shkalles se Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e Dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Gjykata pas analizimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes ka gjetur se faturat si dokumente ne sajë te cilave kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se janë pranuar nga debitori, te njëjta nuk janë te vulosura e as nënshkruar nga debitori ne mënyrë qe te konsiderohen si dokumente te besueshme, ndërsa vlerëson se me te drejt gjykata e shkalles se parë ka vlerësuar se kreditori ne rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht te vlefshme ne mbështetje te pretendimeve te tij.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e Dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkalles se Dytë  
K.DH.SH.II nr.811/24, me datë 24.05.2024

Gjyqtari,  
Ramush Bardiqi